



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 31/2015

Prishtinë, më 28.9.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa - kryetar, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Blerim Grainca, Pal Lekaj dhe Enver Hoti - anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Sasha Milosavleviq, Fatmir Rexhepi dhe Duda Balje - anëtarë.

Pjesëmarrës të ftuar: Mentor Thaqi -UP; Dardan Abazi – INDEP; Valdet Gjinovci –AUV; Diturie Kryziu- MBPZHR; Ilir Salihu dhe Sytrime Dervisholli-MTI; Ramadan Memaj– SHQK dhe Naser Bajraktari-SHPQK.

Pjesëmarrës të tjerë: Milazim Berisha dhe Ardian Purrini-SHPQK; Dafina Krasniqi-SHQK; Naim Huruglica-GFA; Visar Rushiti - GAP; Lejla Selimi – OSBE; Fjolla Uka dhe Genc Jaha- KDI; Sylejman Blaku - Kosova Sot.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 15.09.2015;
3. Çështjet aktuale të pozitës së prodhuesve dhe përpunuesve në industrinë e qumështit;
4. Te ndryshme;

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.09.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 15.09.2015 u miratua pa vërejtje.

3. Çështjet aktuale të pozitës së prodhuesve dhe përpunuesve në industrinë e qumështit

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se kjo pikë tematike e rendit të ditës i përkushtohet problemeve aktuale të pozitës së prodhuesve dhe përpunuesve në industrinë e qumështit. Këto probleme u bënë aktuale edhe gjatë verës, me protestat që u zhvilluan. Në bazë të kësaj, edhe institucionet e tjera, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Komisioni ynë janë marrë me këtë çështje. Ne kemi pasur një vizitë në shoqatat e përpunuesve dhe prodhuesve të qumështit, ku i kemi dëgjuar edhe problemet e tyre, mënyrën se si ata e shohin zgjidhjen e këtyre problemeve dhe kemi vendosur që për to të bëjmë një diskutim tematik dhe ai diskutim tematik të zhvillohet në bazë të dy analizave që i kemi porositur ne, që të bëhen. Analiza e parë ka të bëjë me sfidat dhe problemet në industrinë e qumështit, e përgatitur nga prof. Mentor Thaçi, profesor në Fakultetin e Bujqësisë, gjithashtu një analizë tjetër është bërë lidhur me tregun e prodhimit të qumështit dhe mundësitë për zhvillim të kësaj industrie të tregut, të cilën e ka bërë Instituti INDEP, i cili po ashtu e mbështet Komisionin me asistencë teknike. Arsyeja pse ne sot po merremi me këtë temë për industrinë e qumështit, është se ky sektor, pa mëndyshje, është një prej sektorëve më të rëndësishëm të industrisë së Kosovës. Të gjitha analizat tregojnë se duke marrë parasysh sipërfaqen dhe madhësinë e fermave në Kosovë dhe shumë faktorë të tjerë, Kosova e ka shumë vështirë të jetë konkurrenente me prodhimet tradicionale të bujqësisë, mirëpo janë disa sektorë ku Kosova mund të krijojë përparësi. Sektori i blegtorisë, prodhimi i qumështit dhe përpunimi i mishit, mandej janë edhe disa sektorë të tjerë të pemëve dhe perimeve, ku konsiderohen si sektorë, të cilët mund të zhvillohen. Në vitet e fundit, ne e kemi pasur një zhvillim të industrisë së qumështit, por problemet shihen se janë grumbulluar dhe mund të thuhet se ky sektor gjendet pak a shumë në nivel krize dhe kjo krizë meriton vëmendjen e gjithë aktorëve në shoqëri, sepse ky sektor, me gjithë zinxhirin që mund ta ketë, mund të punësojë ndoshta 20, 30 deri në 40 mijë punëtorë, dhe mu për këtë, ne duhet të shohim se ku qëndrojnë problemet. Pas fjalës së tij, kryetari Mustafa ia dha fjalën ekspertit, prof. Mentor Thaçi, të prezantojë ekspertizën e tij.

Prof. Mentor Thaçi (ekspert i angazhuar nga Komisioni), prezantoi ekspertizën e përgatitur me temën: “Sfidat dhe problemet e industrisë së qumështit në Kosovë”. Temat të cilat i prezantoi eksperti janë: sektori blegtoral në Kosovë; sektori i qumështit në Kosovë; përpunimi i qumështit; bilanci tregtar i sektorit të qumështit; vështirësitë dhe sfidat e sektorit të qumështit; shqyrtimi i subvencioneve rajonale të qumështit; kërkesat e Shoqatës së Prodhuesve të Qumështit (SHPQK) dhe Qumështarëve të Kosovës (SHQK); konkluzionet dhe rekomandimet.

Eksperti, në tërësi, prezantoi ekspertizën, por me theks të veçantë, u ndal te konkluzionet dhe rekomandimet, të cilat i paraqiti si vijon:

Konkluzionet e ekspertit

Prodhimtaria blegtorale ka një rëndësi të veçantë për ekonominë e Kosovës, pasi rreth 52 % të fermave të përgjithshme, janë aktive në prodhimtarinë blegtorale, me të hyra mesatare rreth

270 milionë euro. Mbarështimi i gjedhëve qumështorë është i lidhur drejtpërdrejt me sektorin e mishit, pasi është burim i viçave për majmëri, dhe zvogëlimi i sektorit të qumështit ndikon drejtpërdrejt në zvogëlimin e atij të mishit. Industria e qumështit në Kosovë angazhon mbi 20,000 fuqi punëtorë në të gjitha hallkat e prodhimit dhe përpunimit. Potenciali i tregut të brendshëm është shumë pak i shfrytëzuar dhe ka ende shumë hapësirë për t'u rritur, ndërsa lidhjet e mira me Shqipërinë, nëpërmjet autostradës, duhet të hapin mundësinë për tregje të reja. Nuk ka ndonjë dallim shumë të rëndësishëm të subvencionimit të fermerëve në shtetet e rajonit, e Kosova nuk mbetet prapa vendeve tjera sa i përket mbështetjes së fermerëve. Një dallim i rëndësishëm, është se shtetet e rajonit kanë një politikë shumë më agresive sa i përket mbrojtjes së prodhuesve vendorë në periudhat kritike të rritjes së importit. Programet për mbështetje dhe pagesat e drejtpërdrejta duhet të jepen sipas kriterëve të drejta, transparente dhe me stimulimet e duhura për ta shfrytëzuar deri në fund potencialin e tokës bujqësore dhe fuqisë punëtore, si dhe potencialin e tregut. Sektori ballafaqohet me probleme të fermave të vogla dhe standarde të ulëta të teknologjisë së prodhimit. Çmimi i lartë i ushqimit të kafshëve ndikon që edhe çmimi i qumështit të jetë i lartë. Prodhimet kosovare të qumështit nuk gëzojnë një imazh edhe aq të mirë, pasi konsumatorët u besojnë më shumë prodhimeve të huaja. E njëjta gjë vlen edhe për institucionet shtetërore dhe publike. Industria e qumështit dhe qeveria, duhet zbatuar programe vetëdijësi që konsumatorët të nxiten të konsumojë prodhime qumështi cilësore dhe të shëndetshme, nga prodhimi vendor. Sektori karakterizohet me mungesë të qumështit për përpunim në tetë muajt e vitit (gusht deri në mars), ndërsa gjatë katër muajve tjerë (prill deri në korrik), ka tepriçë të qumështit të freskët. Kjo tepriçë e qumështit, paraqet probleme mjaft serioze për prodhuesit e qumështit, pasi nuk janë në gjendje të plasojnë prodhimin e tyre, por njëkohësisht përpunuesve ju ofrohet deri në dy herë sasi më e madhe e qumështit të freskët, që nuk mund ta absorbojnë. Pasi në Kosovë ka shumë institucione dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare që mbështesin sektorin e qumështit, të dhënat statistikore për numrin e gjedhëve qumështorë, prodhimin, konsumin, dhe numrin e të punësuarve në këtë sektor, dallojnë shumë. Prandaj, duhet koordinuar aktivitetet për zhvillimin e një baze të të dhënave të sakta, që edhe aktivitetet e ndërmarra të arsyetohen me gjendjen dhe shifrat reale.

Rekomandimet e ekspertit

Vendosja e kuotave për periudhën prill – korrik, si masa jotarifore për mbrojtjen e prodhimitarisë vendore, është e mundur sipas Ligjit për masat mbrojtëse në importe, Ligjit antidamping dhe Ligjit për masat kundërbalancuese. Përparësia për ofertuesit vendorë, që është e paraparë tashmë me ligjet në fuqi, por ofertuesit vendorë duhet të konkurrojnë në tender me produkte vendore. Pra, këto ligje dhe udhëzime, t'i mrrin në konsideratë që jo vetëm ofertuesi të jetë vendor, por edhe t'u jepet përparësi prodhimeve vendore. AUV, duhet të jetë shumë më efikas në kontrollin e produkteve të qumështit me yndyrë bimore, duke mos lejuar që ato të quhen “Djathë” apo “Qumësht”, por thjesht “Prodhime me yndyrë bimore”. Pra, deklaratat në artikull për përmbajtjen e yndyrës bimore, të jenë shumë më të dukshme dhe të njoftohen konsumatorët përmes vendosjes së njoftimeve nëpër raftet e shitjes. Të shikohet mundësia e vendosjes së akcizës vetëm për “Prodhimet me yndyrë bimore” që ngjasojnë me djathin e zakonshëm. Subvencionimi i karburanteve është vështirë të realizohet, prej pamundësisë së kontrollit dhe mundësitë e manipulimeve me naftën e subvencionuar. Është iniciativë e Qeverisë së Kosovës dhe shumë shpejt prodhuesit dhe përpunuesit e qumështit do të përfitojnë nga subvencionimi i kamatave të kredive dhe greis periodhe afatgjate. Rishqyrtimi i marrëveshjeve për tregti të lirë është i mundshëm përmes rritjes së kapaciteteve të negociimit me vendet tjera në CEFTA. Prioritet superior ka implementimi i Ligjit antidamping. Shoqatat duhet të mbledhin informatat dhe faturat e çmimeve të qumështit dhe produkteve të qumështit. Departamenti i Tregtisë, pranë MTI-së, pas pranimit të dëshmive të arsyeshme, duhet të zbatojë menjëherë masat sipas ligjeve në fuqi. Agjencia

Doganore e Kosovës, duhet vazhdimisht të zbatojë një politikë për vlerësimin e taksës së importit për qumështin dhe produktet e qumështit. Nëse Dogana shqyrton ndonjë faturë nga një importues dhe ata vlerësojnë se çmimi i deklaruar është më i vogël se vlera e tij në tregun vendor, ata duhet të përmirësojnë atë. Prodhimet e qumështit në tregjet e gjelbra, duhet të trajtohen sipas ligjit, përkitazi aspektit të cilësisë në të njëjtën mënyrë, sikurse të gjitha prodhimet e qumështit të dedikuara për shitje, e tek atëherë mund të bëhet fjalë për garë korrekte në treg, gjë që e shtyn përpara zhvillimin e përgjithshëm. AUV të zbatojë me përpikëri masat e kontrollit të cilësisë dhe të aplikojë masa ndëshkuese, në bazë të rregulloreve në fuqi. Një problem i vërtetë ekziston në importimin e qumështit dhe produkteve të qumështit, për shkak se nuk ka asnjë kufizim, bazuar në datën e skadimit. Prandaj, disa produkte të qumështit të importuar, vijnë në Kosovë, në ose shumë afër datës së tyre të skadimit, duke i lejuar ata që të shiten me çmime nën koston e prodhimit të produkteve të ngjashme të prodhuara në Kosovë. Duhet të përgatitet dhe zbatohet një rregullore për afatin minimal të importimit të çdo produkti të qumështit. Të mbështeten prodhuesit e qumështit që të aplikojnë praktikën më të mira, për të përmirësuar efikasitetin, të ulin koston dhe për të siguruar prodhimin e produkteve cilësore. Përpunuesit të mbështeten në modernizimin e objekteve, zbatimin e standardeve HACCP / ISO 9001 / PMM, dhe të kenë qasje më të sofistikuar në lidhje me marketingun, shitjen dhe shpërndarjen e produkteve. Problemi i mungesës së besimit mund të zgjidhet vetëm bashkërisht nga e gjithë industria e qumështit. Prandaj, prodhuesit e qumështit dhe qumështoret, duhet të zhvillojnë fushata të përbashkëta marketingu për ta rritur ndërgjegjen e popullsisë për prodhime vendore. Fushatat duhet të përqendrohen, në radhë të parë te moshat e reja. Shoqatat duhet përkrahur nga institucionet vendore, pasi deri tani, gati të gjitha kërkesat e shoqatave, edhe pse janë marrë në shqyrtim nga organet qeveritare, përgjigjet kanë qenë negative, dhe shpeshherë përgjegjësia është bartur nga njëri te tjetri institucion qeveritar. Shembull i shteteve të rajonit është marrja e masave adekuate për zgjidhjen e problemeve, edhe në suaza të marrëveshjeve të shumta, të nënshkruara në mes shteteve. Duhet mbështetur marketingun, që është një disiplinë komplekse. Një strategji e optimizuar duhet të përfshijë një artikullimin të pozicionuar të markës, projektimit të produktit, çmimit, shpërndarjen / disponueshmërinë dhe reklamat vetëdijësuese dhe promovimin. Prodhimi i qumështit pluhur me prejardhje vendore, si masë adekuate për zbutjen e tepërcave të qumështit gjatë periudhës kritike. MBPZHR me fondet e granteve për prodhuesit – përpunuesit, mund të mbështesë instalimin e linjave për prodhimin e qumështit pluhur. Vendorsja e prelemanit, që është një zgjidhje e përkohshme dhe që duhet të zbatohet vetëm gjatë muajve prill – korrik të vitit kalendarik. Gjatë periudhës kritike, prill - korrik, të mbulohen shpenzimet e grumbullimit, transportit dhe ngarkesës fiskale të qumështit të freskët, me qëllim që të eksportohet në tregun e Shqipërisë. Të mbështetet nga institucionet, iniciativa e AUV dhe USAID-it, që qumështi i pasterizuar, që ka cilësi më të lartë, pasi përgatitet vetëm nga qumështi ekstra klasë, të zëvendësojë qumështin UHT dhe të ndikojë në zëvendësimin e qumështit të importuar me atë vendor.

Dardan Abazi – INDEP, prezantoi hulumtimin: “Tregu i prodhimeve të qumështit dhe mundësitë e Kosovës për zhvillim”. Temat, të cilat i trajton ekspertiza e Institutit INDEP, janë: Tregu i qumështit dhe prodhimeve të tij; Bilanci tregtar në qumësht; Kërkesat e qumështarëve; Subvencionimi i qumështit dhe politika e ndjekur; përfundim dhe rekomandimet. Theks të veçantë në prezantim, i është vënë përfundimeve dhe rekomandimeve të Institutit INDEP, të cilat janë paraqitur në vijim.

Përfundimet e Institutit INDEP

Problemet e shfaqura në sektorin e qumështit, janë rezultat i një sërë problemesh të akumuluar dhe nuk zgjidhen thjesht me realizimin e të gjitha kërkesave të Shoqatës së Qumështarëve. Sektori i qumështit ka nevojë për një trajtim të veçantë dhe gjithëpërfshirës që

do të përfshinte, që nga politikat e tokës, e deri tek plasimi i produkteve vendore në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm. Numri i fermave bujqësore të identifikuar me regjistrimin bujqësor ka vënë në dukje një fakt shqetësues për zhvillimin e bujqësisë në përgjithësi dhe prodhimtarisë së qumështit në veçanti. Madhësia mesatare e fermave mbetet pothuaj më e ulëta në rajon dhe kjo ka ndikuar dukshëm në segmentimin e kapaciteteve investuese çka ka ndikuar edhe në sasinë e prodhimit, por edhe në cilësinë e produkteve. Për më tepër, tregtimi i politikave të rehabilitimit të tokës dhe rritjes së madhësisë së fermave nuk kanë sjellë rezultate. Procesi i privatizimit të tokave bujqësore nuk arriti të rrisë këtë mesatare. Në programet e subvencionimit janë përmendur vetëm projektet që përfshijnë rehabilitim të tokave që do të cilësohen si projekte me përparësi, por nuk janë vendosur projekte të veçanta në këtë drejtim. Baza e tanishme ligjore nuk mundëson vendosjen e tarifave dhe kuotave doganore, pa u dëshmuar që mallërat e importuara janë të subvencionuara nga ndihmat shtetërore. Në të njëjtën kohë, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, mund të identifikojë dhe ndalojë mallërat të cilat janë të rrezikshme për shëndetin. Pa pasur një vendim të tillë të plotëfuqishëm, kodi doganor nuk do t'i njoh ato mallëra si të ndaluara. Kosova nuk ka një mekanizëm të vetëm të unifikimit të politikave bujqësore me anë të së cilit politikave fiskale, ato të transportit, importit të produkteve, edukimit etj, të mund të funksiononin së bashku. Regjistrimi i bujqësisë i vitit 2014, është një shans i mirë për Kosovën, që të ketë një pasqyrë të qartë të situatës në terren dhe të unifikojë këto politika. Subvencionimi direkt për krerë lopësh nuk ka ndikuar në rritjen e sasisë dhe cilësisë së prodhuar. Vendet e rajonit preferojnë politika të rimbursimit për litër qumësht për të ndikuar në rritjen e prodhimit final. Politika e subvencionimit nuk ka qenë kreativ në klasifikimin e kategorive të prodhuesve, cilësisë së tyre dhe formave të investimit, në atë mënyrë që të krijojë hartën e prodhuesve të qumështit dhe të rrisë gradualisht cilësinë e produkteve. Transporti i qumështit nga fermerët e vegjël tek pikat mbledhëse dhe deri tek fabrika përpunuese, nuk janë të subvencionuara. Fermerët kanë nevojë për mbështetje më të madhe në këtë drejtim. Po ashtu, subvencionimi në këtë fushë nuk përfshin edhe rimbursime të TVSH-së në bazë të prodhimtarisë, etj. Fermat kanë nevojë jo vetëm të rrisin sasinë e prodhuar, por edhe cilësinë e prodhimit, në mënyrë që të jenë konkurrues me produktet e importuara. Cilësia është një nga kërkesat bazë të konsumatorit kur blen produkte të qumështit, dhe po kështu, Qeveria e Kosovës nuk ka bërë sa duhet që të targetojë këtë pjesë të prodhimeve vendore. Në një masë, kërkesat e organizatave të prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit janë të arsyeshme, por ato duhet të shoqërohen nga vlerësimet e institucioneve të thirrura si AUV dhe Qeveria e Kosovës, të cilat ende nuk kanë dhënë vlerësimet përfundimtare në lidhje me këtë problematikë. Realizimi i plotë i të gjitha kërkesave të qumështarëve, nuk do të zgjidhte problemet që ky sektor ka në zhvillimin e mëtutjeshëm.

Rekomandimet e Institutit INDEP

Në mënyrë që sektori i prodhimeve vendore në fushën e qumështit dhe produkteve të tij të rimëkëmbet, që të gjenerojë zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësi të produkteve, INDEP ka identifikuar disa masa të menjëhershme që duhen përfshirë në prioritetet e politikës publike. Disa prej këtyre masave janë në kuadër të gjithë sektorit të bujqësisë e disa janë specifike për sektorin e qumështit. Në këtë dokument janë paraqitur ato më specifike.

Politikat e subvencionimit

Politika e tanishme e subvencionimit është kufizuar në pagesa direkte. Kjo politikë kufizon efektet që një program subvencionimi do të duhej të mbërrinte: skemë e re e subvencionimit, subvencionim në bazë të prodhimit dhe cilësisë së prodhuar, më tepër subvencionim në pajisje që përmirësojnë teknologjinë dhe cilësinë e produkteve, ndarje zonale dhe subvencionim në bazë të llojeve të tokave, madhësisë së tyre dhe kapaciteteve prodhuese.

Politika e tanishme e subvencionimit është kufizuar vetëm në pagesa direkte. Një strukturë e re e subvencionimit do ta pasuronte skemën aktuale me vendosjen e subvencionimit, duke u

bazuar edhe në parametra të tjerë, siç janë: cilësia e prodhuar dhe sasia e prodhuar. Ndarja e pagesave direkte vetëm në bazë të numrit të krerëve të lopëve apo deleve, nuk ndikon domosdoshmërisht në rritjen e prodhimtarisë dhe mbi të gjitha, cilësisë së produkteve.

Tashmë, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës ka një databazë me numrin e qumështoreve, cilësisë së prodhuar dhe kushteve të prodhimit që këto qumështore kanë. Një databazë e tillë do të mund të përdorej për inspektime të rregullta dhe për krijimin e një sistemi interaktiv të subvencionimit në bazë të nevojës, prodhimtarisë, kushteve dhe cilësisë së prodhimit.

Subvencionimi duhet të përfshijë edhe përmirësimin e teknologjisë së prodhimit, nga e cila mund të rritet kualiteti i prodhimeve në mënyrë të konsiderueshme. Ndarja e subvencioneve duhet të bëhet edhe në bazë të cilësisë të tokave dhe madhësive të fermave. Një nivel i subvencioneve që do të ishte progresiv në raport me madhësitë e ngastrave bujqësore do të ndikonte në nxitjen e bashkimit të tokave dhe rritjes së madhësisë mesatare të tyre.

Iniciativa fiskale

Politika shtetërore në fushën e bujqësisë duhet të jetë horizontalisht e integruar. Kjo do të thotë që krahas ndarjes së subvencioneve, të ketë edhe incentiva fiskale si: kategorizim i tatimit në pronë për prona bujqësore, varësisht nga cilësia e prodhimit dhe sasia e prodhuar; lirim nga tatimi në pronë i prodhimeve qumështore, me vëllim të lartë dhe klasë të lartë të prodhimit; lirimin nga dogana dhe akciza dhe shpejtim të procedurave për pajisjet bujqësore, që përdoren në prodhimintarinë e qumështit, me theks të veçantë në pajisjet eficiente.

Një nga politikat e para që do të mund të aplikohet, me një bashkëpunim ndërministror, është kategorizimi i subjekteve ekonomike bujqësore në atë mënyrë që të ketë një sistem fleksibil të mbledhjes së tatimeve nga ta. Komunave duhet tu jepet më shumë liri në mbledhjen e tatimit në pronë në atë mënyrë që tokat bujqësore të cilat mbesin djerrina të pa guajnë më tepër tatim në pronë sesa tokat e tjera dhe po ashtu ato të kategorizohen nga sasia e prodhimit. Prodhimet me klasë dhe vëllim të lartë të prodhimit duhet të inkurajohen që të rrisin prodhimin e tyre.

Politikat e importit

Në pjesën e politikave të importit, u vlerësua si e rëndësishme që Kosova të ketë: Inspektim të rregullt dhe të detajuar të cilësisë së produkteve të importuara; Qasje proaktive e Kosovës në forumet e CEFTA-s dhe në procesin e implementimit të MSA.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë duhet të sigurojë që produktet që hyjnë në tregun e Kosovës si të importuara të kenë kualitetin e përshtetur në dokumentacion dhe të mos rrezikojnë shëndetin e popullatës. Në këtë drejtim Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinës duhet të jetë më transparent me publikimin e të gjitha të dhënave. Po ashtu, doganat e Kosovës duhet të publikojnë listën e tregtarëve që importojnë këto produkte pasi të njëjtit tregtar që importojnë janë edhe që i shesin këto produkte nëpër markete të mëdha dhe që i ekspozojnë ato më tepër sesa produktet vendore. Kosova duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme që prodhuesve të qumështit dhe produkteve të tij të u sigurohet edhe tregu i jashtëm. Eksporti në këtë fushë ka qenë jashtëzakonisht i limituar viteve të fundit. Krahas rritjes së cilësisë së qumështit Kosova duhet të punojë në hapjen e tregut të jashtëm dhe të ndihmojë prodhuesit të shesin prodhimet e tyre. Gjithashtu, në grupet implementuese për implementimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit, Kosova duhet të shfrytëzojë instrumentet e kësaj politike për të investuar në fushën e prodhimtarisë së qumështit.

Politikat në edukim

Ndër të tjera, politika e Kosovës në fushën e bujqësisë, duhet të fokusohet edhe në aspektin e informimit dhe edukimit, duke krijuar një program afatgjatë për edukim të fermerëve prodhues të qumështit dhe/apo produkteve të tij; Organizimi i shërbimit të këshillimit bujqësor falas.

Një program për edukim të fermerëve prodhues të qumështit do të kontribuonte edhe plasimit të produkteve të tyre në mënyrë më efikase. Zyrat komunale për bujqësi duhet, pa përjashtim,

në bazë të një programi të Ministrisë së Bujqësisë, i cili do të siguronte këshillime falas dhe të vazhdueshme për bujqit.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se Ministria e ka formuar një grup pune, që të trajtohet pozita e qumështarëve, siç duket kanë dalë me disa rekomandime, të cilat i kemi pasur në mbledhjen e fundit në Këshillin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, kështu që unë në vazhdim do t'i kisha lutur përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, të cilët nëse kanë komente, të na informojmë se si e shohin ata këtë proces.

Ilir Salihu (këshilltar i Ministres së Tregtisë dhe Industrisë), tha se e përshëndes këtë iniciativë të Komisionit për me rregulluar një çështje kaq të rëndësishme dhe me këtë debat sot, ndoshta po rumbullaksohet trajtimi institucional i kërkesave të shoqatave të qumështorëve dhe përpunuesve të qumështit. Ne i kemi trajtuar me shumë kujdes kërkesat e këtyre shoqatave. Duke u shfaqur ky problem, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka thirrur në takim përfaqësuesit e këtyre shoqatave, përfaqësuesit e AUV-ut, doganave, Inspektoratit të tregut dhe e kanë trajtuar në mënyrë përmbytësore këtë çështje dhe kemi kërkuar me shkrim nga ato shoqata, që t'i paraqesin kërkesat e tyre specifike në drejtim të Qeverisë dhe insitucioneve tjera të Kosovës. Pas marrjes së letrave formale të këtyre shoqatave, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka formuar grupin punues ndërinsitucional, dhe ky grup, siç tha edhe kryetari i këtij Komisioni, ka filluar me punë diku në qershor, ku fillimisht ka filluar me mbledhjen e të dhënave dhe informatave të rëndësishme dhe tani besoj që drejtoresha e Departamentit të Tregtisë, brenda Ministrisë, do t'i paraqesë të gjeturat dhe rekomandimet e këtij Komisioni dhe besoj që do të diskutojmë më tutje.

Sytrime Dërvisholli (drejtoreshë e Departamentit të Tregëtisë në MTI), siç e tha edhe këshilltari, hulumtimet kanë përfshirë edhe të dhënat statistikore të importit, të dhënat e grumbulluara përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme, të dhënat e grumbulluara nga vizitatat e qendrave tregtare të mëdha të shitjes, vizitat dhe takimet me importuesit kryesorë të produkteve të qumështit dhe vizitave dhe takimeve me prodhuesit dhe përpunuesit vendorë të qumështit. Në fillim, kërkesat e dy shoqatave kanë qenë që të merren masa mbrojtëse, për shkak të një fluksi të madh të importeve, ndërsa nga analizat të cilat i ka bërë Departamenti i Tregtisë, në bashkpunim me Komisionin, kemi gjetur se nga periudha trevjeçare 2013-2015, pothuajse kemi një rritje të vogël të disa produkte, në këtë rast të qumështit, por edhe njëkohsisht zvogëlim të importit të produkteve të tjera. Kur analizohet në terësi, tregohet se tregu vendor nuk është atakuar nga ndonjë rritje e dallueshme serioze, do të thotë nuk është shqetsim serioz ajo që e kanë ngritur shoqatat tek Ministria e Tregtisë. Po ashtu, diskutuan edhe dy parafolësit se vendi prej nga importohet më së shumti, do të vazhdojë të jetë Sllovenia diku me 52% të numrit të përgjithshëm të importit. Ekipi, po ashtu, ka analizuar dhe ka siguruar edhe të dhëna nga Ministria e Bujqësisë për nivelin e përgjithshëm të prodhimit të qumështit, të importit të qumështit dhe produkteve të tij, nivelit e konsumit për kokë banori, dhe të dhënat në fjalë tregojnë se, gjatë vitit 2013, prodhimi vjetor i qumështit ka qenë 369 milionë litra. Sipas këtyre të dhënave, konsumi për kokë banori ishte 216 litra në vit, ku del se importi ka qenë 72 milionë litra, ose me përqindje vetëm 16% importohet, përderisa prodhimi vendor mbulon diku rreth 84% të konsumit. Duke e filluar punën, Komisioni, së bashku me Departamentin e Tregtisë, në bazë të Ligjit për masat mbrojtëse në importe, hulumtimi ynë na ka drejtuar në drejtim tjetër në aspektin e Ligjit antidamping. Departamenti i Tregtisë ka gjetur se disa produkte të disa vendeve eksportuese se në Kosovë është shitur nën çmim, në krahasim me vendin e origjinës. Po ashtu, edhe ne, duke e analizuar këtë situatë dhe duke e parë se çmimet nuk janë shumë të ulëta sa që mund të shkaktojnë një dëmtim mjaft serioz, ashtu edhe siç parashihet të bëhet në Ligjin për masat antidamping, kemi

rekomnduar si departament edhe ajo që është diskutuar në Këshillin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik që i është rekomanduar Departamentit të Tregtisë që t'i kontaktojë formalisht këto kompani për të cilat ne kemi dyshime, këto dyshime tona janë të bazuara, sepse i kemi angazhuar edhe ambasadat tona në vendet e origjinës ku edhe i kemi marrë këto të dhënë, mirëpo vetëm ta përmend se i gjithë ky hulumtim është një hetim joformal se në asnjë formë ne si Ministri e Tregtisë nuk e bëjmë një hetim formal, pa e bërë një hetim preliminar dhe pa e parë se a kemi bazë të mëtutjeshme për ato hulumtime pastaj duhet duhet të përfshihen edhe qeveritë përkatëse dhe për ate duhet të jetë një kujdes i shtuar nga ana jonë. Pra, çka është ajo që neve i kemi zbatuar rekomandimet e KPZHE-së dhe menjëherë në datën 14 dhe 15 shtator të këtij muaji, kemi kontaktuar individualisht këto katër kompani ku kemi këkuar rregullimin e çmimeve, të cilat ata i kanë deklaruar. Deri më tani, raporti është zvogëluar falë edhe zbritjes së TVSH-së nga 16% dhe dy kompani të tjera kanë premtuar që shumë shpjet do të rregullojnë këtë çështje dhe ne si departament brenda kësaj Ministrie, do të dalim me raport mbi gjendjen aktuale dhe pastaj do t'i propozojmë ministres, nëse duhet të fillojmë një hetim formal apo jo. D.m.th kjo është gjendja aktuale sa i përket kësaj fushe, kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm edhe me shoqatën e prodhuesve, përpunuesve dhe është më rëndësi të ceket se shqetësimi i tyre nuk ka qenë tek qumështi si produkt, por ka qenë tek produktet e qumështit dhe të gjitha produktet me origjin bimore. Pra, kjo është situata aktuale e sektorit të qumështit që ka bërë Ministria e Tregtisë, në bashkpunim me Komisionin për mbrojtjen e importeve, si dhe të Komisionit për masat antidamping.

Valdet Gjinovci (Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë - AUV), shqetësimet të cilat janë ngritur lidhur me prodhimet e qumështit kanë qenë evidente dhe na kanë përcjellë nga viti në vit. Për këto shqetësime të industrisë së qumështit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka ndërmarrë veprime dhe hapa për adresimin dhe gjetjen e një zgjidhjeje. Në takimin e parë me Ministrinë e Tregëtisë dhe Industrisë, jemi dakorduar mbi hapat të cilët janë ndërmarrë në drejtim të verifikimit të drejtë dhe të saktë të kësaj situate të veçantë të produkteve të cilat vijnë nga importi, dhe në kuadër të kësaj, jemi detyruar që edhe t'ju drejtohem direkt edhe autoriteteve kompetente, në këtë rast shteteve të Bashkimit Evropian, vendeve nga vijnë këto produkte. Është diskutuar edhe për produktet me përmbajtje bimore, ku të gjitha autoritetet përkatëse të cilat iu kemi drejtuar, ato janë përgjigjur me shkresa që të njëjtat produkte të cilat i përdorin në vendet e tyre, janë produkte për të cilat ofrojnë dhe garantojnë siguri, njëherazi i kanë dërguar edhe rregulloret, me të cilat bazohen dhe rregullohen këto produkte për konsumatorët e tyre. Në kuadër të kësaj, duke e pasur parasysh problematiken e vazhdueshme, në bashkpunim edhe me shoqatën, ne do t'i ndërmarrim edhe hapat e fundit të cilët i kemi. Duke e ditur se përdorimi i qumështit në Kosovë sot është në vlera minimale, kohën e fundit kemi pasur një diskutim dhe debat edhe me shoqatat, mirëpo edhe me projektin e USAID-it, i cili është duke mbështetur në vazhdimsi. Do të bëjmë një kampanjë mediatike rreth përdorimit të qumështit të freskët, që të përdoret në masa të konsiderueshme në vend, kështu që në këtë rast, nëse kërkohet mbështetja institucionale edhe nga ana e Komisionit tuaj, do të kërkojmë që të na mbështetsni, për arsye se besoj që në masë të konsiderueshme, do ta ulnim në një shkallë të konsiderueshme përdorimin e qumështit, i cili vjen nga importi dhe do të përdoret në masa të konsiderueshme qumështi i freskët vendor. Fatmirësisht, kemi prodhues të cilët prodhojnë qumësht mjaft cilësor, pra të kategorisë së parë, dhe në këtë drejtim, ajo që ofron Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës te kontrolli i qumështit, të gjitha analizat të cilat bëhen në laboratorin e kësaj Agjencie, kryhen falas dhe nuk i detyrohen Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës, në këtë rast, Qeverisë së Kosovës, që të mos paguajnë asnjë cent për shërbimet që i kryen Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës. Sa i përket importit, tani u fol shumë për pengesat të cilat mund të shkaktohen. Realisht, ne jemi përgjegjës për kontrollin e cilsisë së produkteve, dhe në njëfarë forme, jemi liberal, por nuk

jemi liberal që të importohet diçka e cila nuk është e lejuar dhe që nuk i përmbushë kriteret e sigurisë së prodhimit të produktit. Unë desha të ndërlidhem edhe te kategorizimi. Kategorizimi gjithmonë bëhet në bazë të infrastrukturës, llojit të produkteve të cilat prodhohen, pra që i prodhon industria jonë e qumështit. Industria e qumështit është një industri e cila është duke u bërë lider dhe konkurrent i prodhimeve të vendit dhe të rajonit. Ne besojmë që edhe me mbështetjen tuaj, mirëpo edhe në bashkpunim me shoqatën, po ashtu edhe projekti i USAID –it, i cili do të na mbështesë në këtë kampanjë, e cila mendohet të jetë në dy vitet e ardhëshme, ta ndryshojmë mentalitetin e konsumatorit në përdorim të qumështit të freskët të prodhimit vendor.

Ramadan Memaj (Shoqata e Qumështit të Kosovës - SHQK), ne si shoqatë i kemi disa rezerva sa i përket prezantimit, pra i kemi disa vërejtje. Problemi i statistikave në Kosovë sa i përket sektorit të qumështit, është shumë i madh. E para, këtu po flitet për diku rreth 190 mijë lopë qumështore në Kosovë, ku në qoftë se ne marrin një statistikë, atëherë del që ne në Kosovë jemi duke i prodhuar rreth 2 milionë litra qumësht në ditë, gjë që është jashtë çdo logjike. Për çfarë arsyeje ndodh kjo? Kjo ndodh se çështja e regjistrimit të lopëve në Kosovë dhe çështja e prerjes apo therjes së tyre kohë pas kohe, nuk evidentohet. Pra, për atë kemi numra ku në asnjë mënyrë nuk mund të ndërlidhen me realitetin, sepse po të ishte ky një realitet, del se ky do të ishte konsumi për kokë banori në Kosovë dhe nuk do të ishte 215 litra sipas Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, por do të ishte mbi 400 litra për kokë banori, gjë që do të ishim shembull i cili i tejkalon çdo mesatare në botë. Kjo është vërejtja e parë. Vërjeja e dytë ka të bëjë me çështjen e prodhimit sezonal. Ne nuk mund të pajtohemi me këtë pikë, sepse lopa nuk ka prodhim sezonal, por ka prodhim të vazhdueshëm gjatë vitit. Ekspertët thonë se gjatë muajve të verës zvoglohet konsumi i qumështit. Mendoj që është e kundërta e saj, sepse gjatë muajve të verës, rritet konsumi i saj, ku ne të gjithë e dimë se jetojmë në një vend ku kemi një numër të madh të bashkatdhetarëve tanë që vijnë dhe konsumi i qumështit rritet. Arsyeja pse ne kemi teprica të qumështit në verë është se prodhimi rritet për shkak të kushteve më të mira klimatike. Çështja e importeve, produktet janë të paligjshme, derisa nuk rregullohen me ligj. Pra, do të ishte ndoshta shumë e nevojshme të tregohet se në bazë të cilit ligj apo rregullore lejohet importi i produkteve të qumështit me origjinë bimore, pra si është i rregulluar me legjislacionin e Kosovës importi i këtyre produkteve me yndyrë bimore, të cilat vijnë në Kosovë dhe shiten si produkte të qumështit. Ne nuk e kemi problem shumë të madh importin e qumështit, por problemi dhe kërkesa jonë esenciale vazhdojnë të jenë produktet e paligjshme, produktet të cilat shiten si produkte të qumështit, ndërsa në realitet, në raste të caktuara, nuk e kanë as 1% qumësht dhe mendoj se edhe ky Komision duhet të dalë me një qëndrim pak më konkret lidhur me këtë problem. Çështja e subvencionimit, është shumë e vërtetë, sidomos në këto dy vitet e fundit, kemi një skemë të mirë të subvencionimit të qumështit, mirëpo nuk mund të bëjmë krahasim me industrinë e vendeve të zhvilluara, për faktin se atje janë subvencionuar për 50 vitet e kaluara, ndërsa ne jemi industri e re, në kohën kur ndoshta në vendet e BE-së ndalohet subvencionimi. Mirëpo, edhe çështja e subvencionimit dhe mënyra e subvencionimit për fermerët, janë formuar skema të tilla, edhe pse thuhet se Ministra e Bujqësisë e ka një skemë për subvencionet lidhur me cilësinë e qumështit dhe ndan 1.5 milion euro për cilësi, sipas skemës 6,4 dhe 2 centë. Mirëpo, shtrohet pyetja se sa fermerë janë duke i thithur këto subvencione? Për shembull, vitin e kaluar dhe këtë vit, kanë qenë 400 mijë apo 500 mijë euro, maksimumi që fermerët kanë mundur të marrin, për shkak të pamundësisë që fermerët të përmirësojnë dhe t'i plotësojnë kriteret dhe dokumentacionet tjera, ata nuk mund të jenë prapëseprapë të pranishëm në skemë. Faktikisht, këto janë vërejtjet tona për momentin, sa i përket përfundimeve apo rekomandimeve të cilat i kanë dhënë ekspertët lidhur me kërkesat tona, të cilat mendojmë se janë të arsyeshme duhet të jenë të rëndësishme për të gjithë ne. Pra, ne të

gjithë po pajtohem se ky sektor ka potencialet dhe kapacitetet, prandaj duhet të merremi shumë seriozisht me këtë problem, në qoftë se dëshirojmë të merremi me të dhe t'i japim një zgjidhje problemeve tona, përndryshe në qoftë se nuk ka qasje serioze, atëherë do të vazhdojnë problemet edhe më tutje.

Mentor Thaçi (eksperti)- Gjatë rekomandimeve jam mundur me qenë sa më real dhe e kam përdorur edhe pervojen time që kam punuar edhe me shoqata edhe me sektore të qumështit dhe nuk ja kam mbajtur anën as përpunuesve dhe as prodhuesve. Unë e përmenda se në shumicën e rasteve kërkesat tuaja janë pozitive, por përveç asaj janë edhe disa tjera të cilat nuk kanë qenë as raporte të prodhuesve, as përpunuesve dhe as kërkesa të tyre si qumshiti pluhur e disa të tjera të cilat do t'i ndihmonin edhe sektorit të qumështit. E dyta sa i përket prodhimit në verë, atëherë po ju garantoj me përgjegjësi të plotë se prodhimi në Kosovë gjat verës është dy herë më e madhe. Ne nuk po i llogaritmi gjedhet të cilat janë nëpër shtalla që ushqehen me koncentre. E treta, është një rrëzik mjaft i madh dhe ku duhet të kemi mjaft kujdes, është se bashkësia evropiane prej një maji të këtij viti i ka hequr kuotat që kanë qëndruar që 30 vite për prodhimin e qumështit, dhe mund të them se në Evropë ka rënë çmimi për 30-40% sepse ideja ka qenë me shitur në tregun e Rosisë, Koresë, Kinës dhe në rast të bllokimit të importit nga ato vende mendoj se është rrëzik me ardhur në Kosovë me çmime shumë të lira. Edhe e fundit, ne e përmendim te subvencionimi, neve kemi kapacitete të mjaftueshme dhe se çka u muar vesh do të thotë se ne po prodhojmë më shumë qumësht dhe nuk po mundemi të shesim atë sasi të prodhuar. Ne duhet të mundohemi ta ruajmë faktin për prodhimin vendor edhe gjatë verës edhe gjatë tërë vitit. Te ne nuk ka një Ligj rreth afatit të produktit të importuar, kështu që produktet para afatit të skadimit ju ofrohet me çmim për gjysmë më lirë, ndërsa kanë afat kohor të përdorimit vetëm edhe 10 ditë çka nënkupon se ato produkte janë importu ose afër ose ta marrim një muaj ditë para se te ju skadoj afati ku kanë llogari t'i shesin edhe me 30% të çmimit dhe mendoj se është një problem shumë i madh.

Valdet Gjnovci (AUV) - Vendet e Bashkimit Evropian nuk e kanë të rregullum për prodhimet e produkteve specifike, kështu që ne në shkresat të cilat i kemi bërë përgjigjet të cilat i kemi marrë i kanë tregu edhe vendet apo standardet se ku janë bazuar. I kuptoj të gjitha ato shqetësime të qumështarëve dhe në sëbashku me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë kemi dalur në terren sa i përket edhe emertimeve dhe veprimeve të cilat janë ndërmarrë rreth emertimeve të këtyre produkteve që mos të quhen djathë apo mos të quhen me ato emërtime të cilat nuk janë në të vërtetë, kështu që sëbashku me Ministrinë e Tregtisë kemi ndërmarrë veprime praktike në terren. Sa i përket importit në afat ne qysh në vitin 2011 kemi insistuar që të ndalojmë importin e produkteve me një afat minimumi dy javor, mëpo një gjë e tillë nuk është lënuar me konsultimin e Komisionit Evropian.

Naser Bajraktari (Shoqata e Prodhuesëve të Qumështit të Kosovës SHPQK) - Sa i përket subvencionimit të qumështit pse fermeret nuk kanë mundur që të gjithë t'i gëzohen skemës për cilësi të qumështit, kjo ka ndodhur, jo për shkak të cilësisë, po del që fermeri nuk mundet me konkuruar në atë projekt për shkak se nga Ministria përkatëse nuk ju kanë njohur kontratat e punës të fermerëve me pikat grumbuluese. Pra fermerët të cilët shpërndajnë qumësht nëpër pika të caktuara grumbulluese nuk iu kanë njohur kontratat nga Ministria për me ju bërë pagesa e qumështit, pra ka mbetur një numër shumë i madh i fermerëve të cilët nuk e gëzojnë këtë të drejtë.

Pal Lekaj - Mendoj se është një temë e cila është debatur mjaft edhe opinioni publik njihet mirë me këtë temë dhe mendoj se është shumë shqetësuese, dhe për mua është se të gjitha këto kërkesa që i kanë bërë shoqatat janë legjitime dhe janë të implementuara. Them kështu

sespe nëse nisemi nga ajo që u tha sot, ne në treg sot kemi prodhime që nuk ju dihet prejardhja që nuk testohen në laboratore të caktuara dhe është i vërsuar prej prodhimeve të yndrnave që mendoj se janë shumë të dëmshme edhe për shendetin. Nëse flasim edhe për politikat fiskale mendoj se këtu prapë si Qeveria ka dështuar sepse të vije një prodhim nga një vend tjetër dhe ta mbulojë tregun dhe më një çmim shumë më të lirë, mendoj se atëherë diçka nuk është e pranueshme dhe këtu duhet shteti të veprojë. Ne në treg kemi ushqime të llojllojshme të cilat nuk janë të mbrojtura me asnjë veprim që mendoj ja vlenë për t' i stimuluar prodhimet vendore. U përmenden edhe subvencionet, është e vërtetë se ka subvencione, mirëpo nëse ne kemi hiperprodukt dhe prapë subvencionojne dhe nuk kemi treg dhe “çka” ta shkatërron një treg industrie që më të vërtetë është rrëzikshmëri përmanente për industrinë e qumështit dhe mendoj që Qeveria urgjentisht duhet të veprojë. Përmendëm prapë Ligjin për prekurimin publik që duhet të ndryshojë dhe të ju jep përparësi produkteve, Qeveria që subvencionon nuk ju siguron një përparësi publike dhe prapë po e themë se është një dështim në këtë drejtim. Përmendët TVSH-në që është shumë e lartë, por ajo e cila deri më tani ka qenë e disfavorshme, dhe ne nuk po flasim për ditët e sotme, por po flasim për një periudhë shumë të gjatë që i ka dëmtuar fermerët. Prandaj në këtë drejtim mendoj që Qeveria urgjentisht me ligje të sanksionojë dhe t' i mbrojë prodhimet vendore. Vetë shtetet krijojnë asi barriera për të mbrojtur produktet vendore, e ne e bëjmë të kundërtën. Prandaj këtu shoh që Ministria e Tregtisë, kërkesat që janë legjitime për të mbrojtur prodhimet vendore, dhe urgjentisht të miratohet Ligji që shkon në favor të kësaj industrie që është jetike për zhvillimin e vendit.

Blerim Grainca - Edhe nga prezentimet edhe nga situata në terren shihet se kemi një numër të madhë të problemeve me të cilat ballafaqohet shoqata e qumështarëve, duke filluar nga paracelat e vogla që janë ndër më të ulëtat në rajon, pastaj organizimi i fermave e deri tek organizimi i fermave familjare më të vogla. Po ashtu po e shoh si një problem të veçantë edhe raportin në mes të prodhuesve të qumështit dhe përpunuesve i cili është një problem tjetër i cili duhet të trajtohet. Subvencionet po jepen për numërin në krerë e jo për numrin e sasisë së qumështit të prodhuar. Subvencionohet një i cili i ka 5 apo 6 lopë, kurse nuk subvencionohet për sasinë e qumështit që prodhon, që mund t' i bie se mund ta merr subvencionin, nuk e di ndoshta i shet apo nuk i shet lopët, por mund të mos prodhojë asnjë sasi të qumështit dhe kjo mund t' i bie që faktikisht nuk e kemi subvencionu. Në lidhje me statistikën në qoftë se ju referohemi shoqatave të prodhuesëve atëherë; realisht bien poshtë statistikën për të cilat po flasim, por megjithatë unë do të fokusohesha në ty tri probleme që do të duhej t' i kishum parasysh në qoftëse do të dëshirojmë ta zgjedhim problemin e tyre. U tha që mbi 80% tregu mbulohet nga prodhuesit vendor dhe nëse kjo statistikë është e saktë atëherë; mendoj se jemi në suazat e një normaliteti e një ekonomie tregu që edhe në vendet në rajon edhe në vendet e Bashkimit Evropian janë normale, por në bazë të kësaj rezulton se nuk e kemi gjendjen ashtu siç duhet ta kemi. U përmed se nuk e kemi problem sasinë e prodhimit, prandaj unë po mendoj se kemi problem të kultura e jonë e konsumimit, në vendin tonë kemi problem me sasi të prodhimit të produktit të qumështit. Ne nëse arrijmë me rritë sasinë e konsumimit të qumështit atëherë bien poshtë edhe problemet që kanë të bëjnë me vetëprodhuesit. Mua nuk po më përputhen disa statistika, sidomos kjo që lidhet me prodhimet e Zott-it, dhe si ka mundësi të futet një liter qumësht “Zott” 59 centë, mendoj se në këtë çmim është një disproporcion i madh dhe nuk mund të flitet as për subvencionim të “Zott”-it, në këtë rast sepse nuk mund të jetë subvencionimi 50%, andaj disa statistika janë kontradiktore as çmimet antidoping nuk arrijnë të jenë 40% më të lira.

Enver Hoti – U thanë shumë të dhëna nga eksperti i cili e kishte bërë një raport jashtëzakonisht përmbledhës për gjendjen se si funksionon në vend. U tha po ashtu që një

kërkesë të cilën e ka bërë INDEP-i në dogana posedon një të dhënë që për mua është shqetësuese, që 36% e produkteve të cilat kalojnë nëpër doganë nuk kanë emërtim, nuk kanë cilësim ndoshta nuk kanë as përmbajtje se çka përmbajnë ato produkte apo vetëm si të tilla kalojnë e që për mendimin tim e ulin poshtë qëndrimin e zyrtarit të Agjencisë së ushqimit që thotë se e bëjnë një siguri të madhe, e bëjnë një përcjellje të madhe edhe në dogana. Na u prezentua nga Ministria ku thuhet se 84% e produkteve qumështore i mbulon prodhimi vendor gjë që është pak e çuditshme kur shohim raportet e importit se sa importohen dhe sa eksportohen dhe si kalkulohen këto, ku të dhënat janë jashtëzakonisht të pa përputhshme. Një shqetësim tjetër të statistikave kur flasim është edhe që fondi i blegtorisë në përgjithësi që nga viti 2007 e deri në vitin ku jemi tani në situatën aktuale d.m.th nuk ka rritje, shtrohet pyetja pse? Përfaqësuesit e Qeverisë duhet ta dinë arsyen se pse nuk shtohen? Subvencionet ndahen për krerë të lopëve ose të deleve por nuk ndahen për sasinë e qumështit dhe kapacitetin që e ofronë fermeri. Nga ajo shumë që është e ndarë për subvencionim të cilësisë në vlerë 1 milion e gjysmë, i marrin fermeret dhe kanë përfitua vetëm 400 mijë duke shtuar një problem shumë shqetësues mos njohjen e kontratave të fermereve të cilët i lidhin me pikat grumbulluese dhe këtu automatikisht ngritet çështje, pikat grumbulluese a janë të licencuara? A janë duke punuar në rregulla dhe norma ligjore apo janë duke punuar në të zezën dhe nëse ato punojnë mirë dhe janë të licensuara janë funksionale ligjore atëherë shtrohet menjëherë pyetja se pse Ministria nuk iu njeh ato kontrata atyre pikave grumbulluese dhe mund të them se kjo është shumë shqetësuese. Skema e parë e cila jepet për krerë unë mendoj se këtu ka manipulime, dhe aty në përzgjedhje bëhen selektime. Ka selektime në bashkëpunim edhe me Komuna këtu shihet qartë, që bashkëpunimi i Institucioneve Qendrore me Komuna bëhet në form të selektimit dhe nuk bëhet i mirë sidomos në zyret regjionale të cilat janë për shpërndarjen e subvencioneve dhe evidentimin e saktë të fondit, qoftë të dhive, të deleve apo të lopëve, dhe unë them se ka shumë punë për t'u bërë. Unë dëshiroj që Ministria e Tregtisë raportin të cilin e prezentoj këtu me ua shpërndarë deputetëve, por është dashur atë raport të cilin e lexoj e nderuara përfaqësuese nga Ministria me na shpërndarë të gjithë deputetëve. Ne konsiderojmë se sektori i blegtorisë, në përgjithësi industria e qumështit në veçanti është në një krizë e cila sidomos gjatë verës vjen deri të gjuajtja dhe hedhja e qumështit ku edhe ju vetë e potencuat këtu si reagim i prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit. Masat të cilat po merren për mbrojtjen e tyre edhe këtu u deklaruan që nuk janë ato adekuate, mirëpo na tërhoqi vërejtjen ekspertit që tha se ka masa që shumë shtete i marrin në kohën dhe fazën kur kanë prodhim më të madh duke i sanksionuar me urdhëresat administrative që ndikojnë në masat mbrojtëse për prodhimin e tyre. Dhe mbetet të thuhet se ndoshta ne kemi një treg që po e mbysim vetë tregun tonë.

Besim Beqaj - Tranzicioni i cili ka ndodhur gjatë këtyre viteve, d.m.th që nga koha kur kam qenë kryetar i Odes Ekonomike dhe tri postet ministrore edhe tash si deputet dhe mund të them se duhet të pajtohem me një realitet se ky sektor është rritur shumë edhe në sektoret institucional edhe në skemat e subvencionimit dhe nuk është e saktë që nuk subvencionohet në prodhime. Në cilësi duhet që të subvencionohet prodhimi i cili del dhe arsyeja pse këta nuk mund t'i marrin subvencionet unë ju tregoj sepse në kohën kur isha unë ishte kusht që të gjithë fermert që dëshirojnë të përfitojnë për lirin nga TVSH të jenë të regjistruar, pra pa qenë të regjistruar pa qenë pjesë në rregullin e tregut formal ata nuk mund të jenë pjesë e tyre. Duhet të kuptohemi që ne kemi arritur prej një momenti që ndoshta as 30% nuk ishte mbulueshmëria ku tani është 70 apo 80%. Pra, them se nuk jemi ka e shkatërrim, por jemi ka e zhvillim, dhe unë mund të them se ky sektor është zhvilluar sepse mbulueshmëria është shumë e madhe deri në 75% tregut. Te pikat e grumbullimit pse nuk njihen kontratat e pikave të grumbullimit duhet ta parashtrojmë pyetjen se a janë ato pika grumbulluese të regjistruara? Këta fermerë të prodhimit primar a kanë licencë? Asnjëherë as prej ekspertit, dhe

as prej INDEP-i dhe as prej jush nuk e dëgjova fjalën e konkurrueshmërisë të produkteve të juaja edhe çmimin. Shteti mund të ju ndihmoj me parandaluar shitjen ilegale të produkteve dhe e ka obligim nëse nuk e bën ju duhet ta paditni. Me paditur Ministrinë, nëse keni fakte, është diçka joligjore. Për me mbrojtur tregun ekziston Ligji Antidamping, dhe askush nuk ju ndalon juve dhe askujt për me i marr masat antidamping dhe nëse ju kujtohet para katër viteve apo pesë kemi pasur rastin me qumështin që vinte nga Hungaria kemi kërkuar dhe kemi argumentuar dhe kemi marrë masa dhe është ndaluar inporti sepse ka pasur përmasa të sakta të verifikume që është çmim i danpingut. Pra, ekzistojnë masat ligjore të cilat nuk e parandalojnë as Ministrinë e Tregtisë, as agjencia e ushqimit të veterinarsë edhe përcilësi edhe për deklarim të rrejshëm edhe për gjëra të tjera të cilat nuk janë në harmoni me të në qoftë se është fjala për subvencionim agresiv të shtetit për me marr masa, por këtu duhet fakte të cilat neve duhet t'i trajtojmë. Problem themelor në vete këtu, simbas vlersimit tim që 11 vjet është zbatimi i kontratës në mes të prodhuesit dhe të perpunuesit. Protestat bëhen jo për shkak të prodhuesve, por për shkak të përpunuesve, prodhuesit janë instrument i përpunuesve të qumështit. U përmend këtu inportimi i paisjeve e paskemi edhe ish-drejtorinë e doganave, cila paisje që 10 vjet që unë e kam përcjellë nuk është lejuar që mos me u inportuar për prodhim të qumështit a mund të na thotë ndokush, cila paisje me emër, me numër tarifar nuk është lejuar? Paisjet kanë qenë të liruara gjithë herë prej doganës dhe janë të liruara, edhe prej TVSH-së, pra asnjëherë dhe në asnjë rrethanë që 10 vjet paisjet për prodhimin e qumështit nuk kanë qenë të ngarkuara as me TVSH, as me doganë. Tek yndyra bimore, sepse kjo është temë në vete deklarimi i cili hynë dhe bëhet i rrejshëm është pjesë e drejtpërdrejtë e cila bëhet me sigurimin e ushqimit dhe agjensioni i ushqimit duhet të vepron por nuk mund të kërkohet që të ndalohet ky prodhim me origjinë të yndyrës bimore. Atëherë është çështje e ngritjes së vetëdijes dhe marketingut që ju duhet ta bëni bashkarisht edhe me prodhuesin edhe me distributorin edhe me konsumatorin e fundit. Une besoj që detyrë e shtetit është që ta ketë parasysh konsumatorin sigurinë e konsumatorit dhe këtu nëse kemi ligje të këqija duhet të na thoni se cili ligj, cili nen është i keq ose cila pikë e ligjit nuk po zbatohet në mënyrë që ne të thërrasim si komisionin, si Parlament në përgjegjësi institucionet të cilat janë zbatues të ligjit dhe të shofim se a janë ashtu a jo? Pra ky është sygjërimi im sepse industria është zhvilluar shumë dhe ne nuk mund të dalim me konkludim nga këtu që industria është duke shkuar drejt shkatërrimit. Sepse po të mos ishte rritur industria nuk ish rritur cilësia hiç. Sektori ka nevojë për me u zhvilluar ma shumë, por ka nevojë edhe nga ana juaj për konkurrueshmëri edhe deklarime të sakta ligjore për shkelje të çfarëdo lloj procedure dhe nisni procedura dergoni në gjykat. Nëse një zyrtar nuk e ka zbatuar ligjin i kujdo qoftë dërgojeni në prokurori, rruga e vetme për me zbardhur rastin dhe për me pasur sukses. Tregoni se cilat ligje janë keq dhe ulemi bashkarisht i përmirësojmë ato ligje sepse ky është roli i Kuvendit.

Raif Qelaj - Që të gjithë parafolsit e treguan dhe diskutuan për problemin e sigurimit të tregut të qumështit dhe produktet e qumështit dhe ky është problem real. Sado që qumështi dhe produktet e tij në përgjithësi në Kosovë nuk janë duke stagnuar apo duke u shkatërruar, por përkundrazi është duke u zhvilluar, por mund të themi se megjithatë ka problem me plasimin në treg. Çdo shtet mund të ketë në tregun e lirë probleme të tilla, edhe shtetet më të zhvilluara kanë probleme me plasimin në treg të produkteve të tyre, por shteti duhet t'i ndërmarrë ato masa në suaza të ligjeve ekzistuese. Padyshim që në rrethana në të cilat ndodhet Kosova si një shtet i pazhvilluar i ka problemet e veta të cilat janë më të mëdha se sa problemet e shteteve të rajonit të cilat janë shumë më përpara në shumë prej fushave, prandaj shtetet e tjera e kanë më të lehtë që produktet t'i kenë me çmim më të lirë. Institucionet e Kosovës edhe Kuvendi i Kosovës duhet t'i ndërmarrin vetëm ato masa të cilat mund t'i ndërmarrin dhe këtu siç e pashë edhe para parafolësve të mi, Kuvendi duhet ta shqyrtojë a është duke u zbatuar a jo Ligji Antidamping edhe për masat kundërbalancuese, si dhe të

shqyrtohet mundësia e Ligjit për Prokurorimin Publik që të ketë mundësi kur ka tender të hapur që jo vetëm të përkrahim operatorët ekonomik vendor por që edhe të theksohet që prodhimet të jenë vendore, nëse dojmë ta përkrahim prodhimin vendor.

Ramadan Memaj (SHQK) - Mendoj se jemi në një konkurrencë realisht të pabarabartë dhe jo të drejtë me ato produkte të cilat vijnë nuk janë nga qumështi dhe shiten si produkte të qumështit dhe nuk mund të flasim këtu për një konkurueshmëri. Nuk është ky problemi i kontratave, unë ju garantoj që ne si shoqatë e përpunuesve të qumështit mbi 90% të kontratave janë të rregulluara, mirëpo nuk mundesh me e detyruar një përpunues i cili ballafaqohet me keso lloj konkurrence në treg me e detyruar që ai ta grumbullojë qumështin në kohën kur ai nuk pritët me u shitur, këto janë biznese dhe faktikisht logjika e biznesit nuk është kundër që ai të mos grumbullojë qumështin, secili prej nesh ndoshta kish me tentuar që gjithsesi qumështin me grumbulluar e me shitur. Çështja e prokurorit publik, një aspekt është përparsia ose mënyra se si është rregulluar pozicioni i produkteve vendore në tender dhe në aspektin tjetër është mashtrim që bëhet me paranë publike. Ne e kemi rastin si p.sh. institucionet blejnë produkte të qumështit, në kontratë e kanë, ai thotë furnizim me djathë p.sh. kaq tona, në fakt nuk shet djathë por shet një produkt tjetër me yndyrë bimore me një çmim shumë më të ulët. Unë ju garantoj që 80% e produkteve që shiten për djathë të bardhë nëpër marketa që vijnë nga inporti nuk janë nga qumështi, pra kemi të bëjmë me një problem shumë serioz. Janë mbi tre milionë kilogram në vit importe të këtyre produkteve të yndyrave bimore. Deri pak para disa muajve është deklaruar si djathë në etiketën e prodhuesit në vendin e origjinës, te vendi i bashkimit evropian nuk është shënuar si djathë por në vendet tjera po, d.m.th. përkthimi në gjuhën shqipe është shënuar djathë. Edhe sot p.sh. mbas disa veprimeve që janë bërë dhe janë marrë nga agjencioni i ushqimit dhe Ministria e Bujqësisë shihet se këto produkte shiten me emra të ndryshëm dhe janë diku rreth 40 produkte ku një pjesë shitet për kaqkavall, ndërsa pjesa tjetër shitet për djathë, por problemi është mandej të mënyra e shitjes. Mirëpo tash po e marrim edhe aspektin tjetër të konkurueshmëria, por edhe sikur këto produkte të jenë të rregulluara me ligj edhe sikur të hynë në doganë dhe të shiten ashtu si duhet, në qoftë se ato paraqesin një rrezikshmëri të madhe për prodhimin vendor prapëseprapë këtu do të gjindet një zgjidhje nuk mund të lejohet për shkak të një mosmarrëveshje të shkatërrohet prodhimi vendor edhe sikur ato të jenë të rregullta ku në këtë rast apsolutisht nuk janë të rregullta.

Enver Hoti - Desha të them se është shkatërruar industria, por unë thashë se industria është në krizë, është një konstatim dhe ajo nuk don ndonjë koment dhe ne tani e kemi edhe përfaqësuesin e INDEP-it dhe faktet përpara ku mund të them se është mjaft shqetësuese ku këtu shkruhet 36% dhe asnjëri nuk e përmend çka ndodh me ato 36% të produkteve pa emërtim dhe jemi të gjithë dëshmitarë të asaj se kemi këtu një tregti joformale ku na prezentoj shumë mirë përfaqësuesi i qumështorëve të Kosovës që ka një tregtim të dyshuar, prandaj unë mendoj se këto fakte duhet t'i merrni seriozisht dhe t'i zgjidhni.

Blrim Grainca - Pa dashur me i përsëritur gjërat nga diskutimi i fundit i përfaqësuesit të shoqatës së qumështit një shifer që e përmendi ky është një shifer tejet alarmante tre milionë kilogram të produkteve me yndyrë bimore, të dhëna zyrtare të hyrave të produkteve, të cilat mund të shiten si djathë, e nuk janë djathë.

Pal Lekaj - Edhe pse u përmendën shifra 70 e 80 % të mbulueshmërisë të tregut në Kosovë prapë mendoj se ekziston një shpërputhje në mes atyre që prodhojnë dhe përpunuesve. U përmend tregu dhe me plot të drejtë me fanatizëm e mbrojë se produktet e tjera të cilat hynë në Kosovë e bëjnë disbalancin dhe e shkatërrojnë prodhimin vendor, prandaj në këtë drejtim

jemi të obliguar edhe Qeveria, përpos cilësisë në pyetje për mua është shëndeti i njeriut primar dhe nuk është për të mbrojtur një ndërmarrje apo biznes dhe nëse thuhet ne doganë 36% që hynë mbrenda në sasi të vlerës në përqindje ajo është shifër marramendëse dhe për mua është mjaft shqetësuese për shëndetin e qytetarëve tanë dhe ne duhet ta mbrojmë së pari qytetarin pastaj edhe biznesin se për këtë jemi të thirrur.

Daradan Abazi (INDEP) - Një sqarim sa i përket shifres 36%, kur u jemi drejtuar doganave të Kosovës, ne ju kemi drejtuar me tri pyetje themelore çka importojnë? Kush importon? Dhe prej nga importojnë? Prej nga importojmë e kemi marrë informacionin, kush importon nuk e kemi marrë listën e tregtareve për shkak se është shumë me rëndësi për ne ta dijmë se cilët tregëtarë importojnë dhe çka importohet. Te shifra se çka importohet kur e kemi marrë listen e produkteve shumica prej tyre nuk kanë pasur shpjegim a janë me origjinë të yndyrave bimore a janë me origjinë të yndyrave shtazore, por për 36% të produkteve është thënë që janë produkte të tjera nuk është dhënë kurrfarë shpjegimi tjetër, pra nuk është e qartë.

Valdet Gjinovci (AUV) - Unë për 36% nuk kam sqarim, ndërsa sa i përket asaj që po flitet rreth 3 milionë tonë të produkteve, ne për emertim i kemi marrë veprimet, nuk shkruan djathë ai i cili e ka përmbytjen me yndyrë bimore, por sa i përket aspektit të sigurisë janë vetë autoritetet përkatëse të cilat drejtohen edhe referohen edhe në standarde në të cilat duhet të bazohemi për produkte për të cilat ne i kemi ngritur si shqetsim. Sa i përket asaj kontrolli, lirisht mund të them se është një kontroll që realizohet nga inspektoret e agjencisë.

Mentor Thaçi (ekspert) - Sa i përket këtyre produkteve me përmbytje të yndyrave bimore tash mund të thotë ndokush se çka po importohet në Kosovë? Unë kam hyrë dhe kam shikuar se çka janë këto produkte bimore, befasisht në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian këto edhe preferohen sepse kanë më pak edhe kolesterol dhe janë më të shëndetshme për organizmin e njeriut edhe janë më të lira. Tash unë nuk mund të them se janë të dëmshme, bile ata e preferonin se janë më të shëndetshme edhe shumica e njerëzve në Bashkimin Evropian blejnë sepse janë për zemër më të mira, por tash a e demtojnë tregun e Kosovës a jo është normal që e demtojnë, sepse janë shumë më të lira, por të mos del se po prodhojmë produkte të rrëzikshme për shëndetin e njeriut.

Kryetari - Në bazë të këtij debati ne e pamë se ku janë problemet, andaj, një nga konkluzat e para mendoj se do të duhet të konstatohet sepse në qoftë se ne e kemi arritur 80%, atëherë ne jemi shumë mirë dhe pyetja nuk shtrohet më për tregun vendor, por pyetja shtrohet se si ta rrisim konkurshmërinë e prodhimit për eksport d.m.th në tezen e kemi të gabueshme, përndryshe këto qumështore nuk kanë ku me u rritur, pra janë çështje shumë esenciale. Prandaj mu për këtë unë po insistoja edhe te Ministria e Tregtisë edhe te Ministria e Bujqësisë edhe të statistikave edhe të Dogana edhe të prodhuesit që ta kenë këtë të dhënë të saktë, sepse unë mendoj se prej saj duhet me u nis politika prej kësaj të dhëne. E dyta, është aftësia ende e pamjaftueshme e konkurrencës e kësaj industrie dhe nën dy tregu i çrregulluar si mungesë e kapaciteteve institucionale dhe angazhimit të duhur që të zbatohet Ligji, të zbatohet mbrojtja edhe të zbatohet konkurrenca fer. Pra është esenciale rritja e aftësisë së juaj konkurruese, uljes së kostos, përmirësimi i dizajnit edhe shumë sende të tjera që ju të eksportoni, sepse ju nuk mundeni me u rritur në qoftë se kaq shumë plotësohen nevojat e tregut vendor. Në qoftë se ne kemi problem me një sezon, ju nuk duhet me e pohuar, që është problem i tërë vitit, por të thoni se problemi është në atë sezonë, ne mundemi me pasur një mbrojtje të lehtë, këtë as nuk e ndalon CEFTA as askush, tre muaj ne me e mbrojtë prodhimin vendor në mënyrë që të mos ndëmtohen prodhuesit. Në qoftë se Serbia është në CEFTA dhe Serbia e bënë në bazë të Ligjit atëherë duhet ta bëjmë edhe ne. E treta, tek

yndyrat bimore, ne po e kërkojmë që jo me shkel Ligjin, por për me bërë çka bënë krejt bota, dhe me hequr atë kompelks që nuk guxojmë na me i mbrojtur prodhimet vendore, dhe me bërë brenda rregullave qysh bëjnë të gjithë me vepruar. Te çështja e yndyrave bimore, në qoftëse është e saktë kjo ne duhet me e shqyrtuar nevojën e futjes së një akcize, jo me ndaluar, por me futur akcizë, duhet me i shqyrtuar të gjitha mundesit dhe me e futur një akcizë. E katërta, subvencionet duhet me i analizuar. Është mirë me e bërë një analizë, ne do t'i kërkojmë, ndoshta komisionit për bujqësi është më kompetent për këtë çështje për me e analizu politikën e subvencioneve sepse ne që disa vite po japim subvencione dhe të dihet cilat janë efektet e subvencioneve. Sa kemi parë ne, nuk janë dhënë efekte rritja e subvencioneve sepse në bazë të këtyre statistikave që i kemi prodhimi ka mbetur aty dikund numri i krerëve të gjedheve po ashtu ka mbetur i njëjtë atëherë ne duhet me e parë se ku është efekti i subvencioneve. Ndoshta kishte me qenë shumë më keq po sikur të mos ishin subvencionet dhe unë besojë që do ishte më keq, por duhet ne me e parë ne efektin e subvencioneve. Çështja e prokurorit publik, ne jemi pak a shumë më shumë përkrahës të importuesve vendorë sesa të prodhuesve vendor, pra këtu janë politikat që duhet na t'i disiplinojmë në këtë drejtim se në qoftë se importuesit janë edhe distributuesit e brendshëm ata mund të kenë një lloj konflikti të interesit aty dhe ata nuk i ekspozojnë prodhimet vendore, në vend që me i treguar se është me yndyrë bimore e vendosin emërtimin djathë ose kaqkavall sepse ai është importues dhe ai ka supermarket dhe interesi i tij është shitja e tyre, andaj këtu është i nevojshëm angazhimi i inspeksionit. Po ashtu edhe çështja e kontratave mes prodhuesëve dhe përpunuesve ashtu siç e cekim edhe z.Beqaj duhet të rregullohet.

Pas debatit, Komisioni njëzëri, nxori këto:

K o n k l u z i o n e

- 1. Shoqatat e qumështit dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Bujqësisë dhe Dogana të sigurojnë statistika të saktë për prodhimin e qumështit dhe mbulueshmërinë e tregut vendor me qumësht dhe produkte të qumështit;*
- 2. Zyrtarisht t'i kërkohej Doganës të sqarojë kategorinë "Të tjera" që përfshinë 36%, se cilat produkte janë të përfshira në këtë kategori;*
- 3. Të përgatitet nga stafi i Komisionit një përmbledhje ekzekutive me të gjitha çështjet e trajtuara rreth problematikës së industrisë së qumështit, dhe në mbledhjen e radhës Komisioni të nxjerrë rekomandimet për Kuvendin.*

4. Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa